

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga qasja ushtarake te “karantina” gjeopolitike, çfarë fiton realisht SHBA-ja në Grenlandë me marrëveshjen e Trump                                                                                                                                                                                                  |
| ADRESA  | <a href="https://top-channel.tv/2026/09/19/nga-qasja-ushtarake-te-karantina-gjeopolitike-cfare-fiton-realisht-shba-ja-ne-grenlande-me-marreveshjen-e-trump/">https://top-channel.tv/2026/09/19/nga-qasja-ushtarake-te-karantina-gjeopolitike-cfare-fiton-realisht-shba-ja-ne-grenlande-me-marreveshjen-e-trump/</a> |
| BURIMI  | top-channel.tv                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE     | 19 shtator 2026, 14:52:00 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                                                                                                                                                                                                                                           |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 14:46:00 UTC<br><i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën <b>text_date</b>. Dritarja: 19 shtator 2026, 14:45:00 UTC → 19 shtator 2026, 14:47:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 32aca27c796cf5a5317b5b513b24e56afa9b33a1bda6b38e25875b3d8e2272f4 |
| TEKSTI     | 966c2abd56912b4a7070658dc52b060da292ec496362b9920ba2426bb14f9653 |
| PAMJA      | daaa382dd9e6b0a848dcfa14529fdcaea50881023b7b7b8181588676b32fbe18 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | e523f4df4bafef0ebcedd2942815dd01d86be145b12b197501745b0139a51cd2                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 46a7af3000d16e9ffefcbfa0ca0d8af83c85fda72b67353c14db1e839b49f770                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e523f4df4bafef0ebcedd2942815dd01d86be145b12b197501745b0139a51cd2>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



BOTA KRYESORE TË FUNDIT

## Nga qasja ushtarake te "karantina" gjeopolitike, çfarë fiton realisht SHBA-ja në Grenlandë me marrëveshjen e Trump

19/09/2026 16:46



Marrëveshja e re për Grenlandën, e prezantuar nga presidenti amerikan Donald Trump si një marrëveshje që i siguron Shteteve të Bashkuara "kontroll të përhershëm" mbi sigurinë e ishullit, nuk i jep Uashingtonit sovranitet mbi territorin dhe nuk e shndërron Grenlandën në territor amerikan.

Në vend të kësaj, marrëveshja synon të forcojë dhe zgjasë statusin strategjik të SHBA-së në ishull, duke zgjeruar jo vetëm të drejtat për praninë ushtarake, por edhe duke kufizuar mundësinë që shtetet e treta të krijojnë prani ushtarake apo të kryejnë investime të ndjeshme strategjike.

Prania ushtarake amerikane në Grenlandë nuk është një zhvillim i ri. Ajo nisi gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa baza kryesore ligjore e pranisë amerikane është marrëveshja e nënshkruar më 27 prill 1951 mes Shteteve të Bashkuara dhe Danimarkës.

Marrëveshja e vitit 1951 u jepte SHBA-së të drejta të gjera për krijimin e zonave mbrojtëse, ndërtimin dhe operimin e instalimeve ushtarake, vendosjen e pajisjeve dhe furnizimeve, si dhe lëvizjen e forcave përmes tokës, hapësirës ajrore dhe ujërave territoriale të Grenlandës.

Gjatë Luftës së Ftohtë, prania amerikane në ishull u zgjerua ndjeshëm për shkak të pozicionit strategjik të Grenlandës, e cila ndodhet në rrugët veriore mes Rusisë dhe Amerikës së Veriut dhe ka rëndësi të veçantë për paralajmërimin e hershëm ndaj raketave balistike.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, prania amerikane u reduktua. Në vitin 2004, Marrëveshja Igaliku ndryshoi kuadrin e vitit 1951 dhe përcaktoi bazën ajrore Thule, sot Baza Hapësinore Pituffik, si zonën aktive të mbrojtjes amerikane në Grenlandë.

Megjithatë, marrëveshja e vitit 2004 nuk e përjashtonte mundësinë e krijimit të zonave të reja mbrojtëse amerikane. Ajo ruante mekanizmin që lejonte krijimin e tyre përmes marrëveshjes mes palëve.

Ndryshimi i rëndësishëm që sjell kuadri i ri lidhet me kufizimin e pranisë së fuqive të treta. Sipas marrëveshjes së re, vendet që nuk janë anëtare të NATO-s nuk do të mund të krijojnë baza ushtarake apo një prani të ngjashme ushtarake në Grenlandë.

Kjo masë lidhet kryesisht me Rusinë dhe Kinën dhe përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në krahasim me marrëveshjen e vitit 1951. Nëse marrëveshja e vjetër përcaktonte kryesisht mënyrën se si SHBA-ja mund ta përdorte Grenlandën për mbrojtjen e Atlantikut të Veriut, kuadri i ri synon të përcaktojë edhe hapësirën që do t'u lihet fuqive konkurruese në ishull.

### Kryesore



"Kryeqyteti nuk mund t'ua japë lirinë, por mund t'i nderojë"/ 'Qytetar Nderi' për liderët e UÇK-së, Veliaj ia propozon nga burgu këshillit bashkiak të Tiranës

14:07

"Prania Besnike", zbardhet mbledhja e djeshme/ Qindra ankesa dhe dëgjesa në të gjithë vendin, Rama: Nuk është ideja thjeshtë që të marrim e të çojmë halle

08:26

Raporti i prodhuar gabim nga AI gati sa nuk shkaktoi luftë SHBA-Kinë, ushtria amerikane u përgatit të ndalonte anijen kineze

08:01

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

10:07

Kush janë surprizat e Maranit? Një rikthim i madh, dy debutues dhe disa mungesa të bujshme

11:11

### Më të lexuarat

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

"Je e bukur, do të vish në hotelin tim?"/ Modelja kolumbiane publikon bisedën me futbollistin e njohur

Video/ U kap mat me gruan e një tjetri, momenti i frikshëm kur burri bie nga dritarja teksa tentoi të arratiset

Bashkëshortja e Alban Hoxhës humbi jetën pas lindjes së djalit, Gjykata e Lartë rrezon rekursin e dy mjekëve

SHBA dhe Danimarka arrijnë marrëveshje për Groenlandën pas kërcënimeve të Trump për aneksim

Krim i rëndë në familje në Tiranë/ 68-vjeçari vret gruan me thikë dhe arratiset nga vendngjarja, reagon policia

E papritur/ Ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare influencerja e njohur pak javë pas operacionit për gjoksin

Foto/ Vrau gruan me thikë brenda në banesë, vetëdorëzohet autori 68-vjeçar i krimit në Tiranë. Ngjarja u pa nga nipi i mitur

Reagimet pas ekspozimit të rrobave të Çerçiz Topullit, jep dorëheqjen kreu i

Një tjetër element i rëndësishëm janë investimet. Marrëveshja përfshin kufizime ndaj investimeve të ndjeshme nga shtetet që konsiderohen konkurrentë strategjikë të SHBA-së. Trump ka deklaruar se investime të tilla nga vende jashtë NATO-s do të kërkonin miratimin amerikan.

Kjo çështje merr rëndësi për shkak të pasurive minerale dhe lëndëve të para kritike të Grendlandës, si dhe rëndësisë në rritje të infrastrukturës portuale, aeroporteve, telekomunikacionit dhe energjisë në Arktik.

Megjithatë, teksti i plotë ligjor i marrëveshjes nuk është bërë ende publik dhe Kopenhageni dhe Nuuk nuk kanë miratuar të gjitha formulimet e përdorura nga Trump për fushën e kontrollit amerikan. Për këtë arsye, përshkrimi politik i marrëveshjes nga Shtëpia e Bardhë duhet dalluar nga kompetencat që do të përcaktohen përfundimisht në tekstin detyrues.

Grenlanda ka gjithashtu një rol të rëndësishëm në planet amerikane për "Kupolën e Artë", sistemin e ri të mbrojtjes rakitore të SHBA-së. Baza Hapësinore Pituffik tashmë strehon kapacitete për paralajmërimin e hershëm dhe mbikëqyrjen hapësinore, ndërsa një prani më e madhe amerikane mund të sjellë radarë, sensorë, sisteme komunikimi dhe infrastrukturë shtesë të lidhur me mbrojtjen rakitore.

Pavarësisht zgjerimit të rolit amerikan, marrëveshja e re nuk ndryshon sovranitetin mbi Grendlandën. Korniza e re riafirmon sovranitetin dhe integritetin territorial të Mbretërisë së Danimarkës, si dhe të drejtën e banorëve të Grendlandës për vetëvendosje.

Një nga çështjet më të rëndësishme afatgjata është edhe statusi i ardhshëm i ishullit. Marrëveshja synon të ruajë praninë strategjike amerikane edhe në rast se Grenlanda bëhet një ditë plotësisht e pavarur nga Danimarka.

Në këtë mënyrë, ndryshimi kryesor mes marrëveshjes së vitit 1951 dhe kuadrit të ri nuk qëndron thjesht te prania ushtarake amerikane. SHBA-ja e ka pasur këtë prani për dekada. Marrëveshja e re synon të zgjerojë arkitekturën e sigurisë duke kufizuar njëkohësisht mundësinë e krijimit të një pranie strategjike nga Kina, Rusia apo fuqi të tjera konkurruese.

Grenlanda, për shkak të pozicionit të saj gjeografik, burimeve minerale dhe rolit në mbrojtjen rakitore, po merr kështu një rëndësi gjithnjë e më të madhe në strategjinë amerikane për Arktikun dhe sigurinë kombëtare.

Top Channel

Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastër

Influencuesja 21-vjeçare u nxor zvarrë nga shtëpia dhe u ekzekutua para syve të babait të saj

## I Bota »



**Dronë mbi aeroportin e Luksemburgut/ Pezullohen fluturimet, 1,800 pasagjerë të prekur**

19/09 16:24



**SHBA miraton paraprakisht paketën ushtarake 2.7 mld dollarë për Ukrainën, përfshihen raketa dhe sisteme kundër dronëve**

19/09 16:18



**PISA 2025/ Alarm në arsimin europian, Franca, Gjermania, Holanda e Finlanda në nivelet më të ulëta**

19/09 16:12




**Sulm kibernetik para zgjedhjeve në Rusi? Hakerët pretendojnë qasje në sistemet zgjedhore**

19/09 16:00



**Tragjedia në Venecia/ Taksisti nën hetim për vdekjen e një çifti, në gjak dhe urinë iu gjetën alkool dhe drogë**

19/09 14:00



**Foshnja 3-muajshe vdiq nga kequshqyerja e rëndë, prindërit përballen me akuzën për vrasje**

19/09 13:29

## I Kryesore »





**Shqipëria e 44-ta në nivel global në Indeksin e SDG-ve për vitin 2026, Rama: Do të vazhdojmë të ecim përpara**

19/09 16:50



**Sulm kibernetik para zgjedhjeve në Rusi? Hakerët pretendojnë qasje në sistemet zgjedhore**

19/09 16:00



**Alarm në Zvicër për Granit Xhakën, prokuroria hap hetim për certifikatat e COVID-it**

19/09 15:58



**Perspektivë pozitive e Shqipërisë/ Moody's mban vlerësimin 'Ba3', sheh rritje 3.6% të ekonomisë dhe ulje graduale të borxhit**

19/09 15:24



**Më 8 tetor miratohet harta e re territoriale/ Votat në favor të mazhorancës, PD kundër**

19/09 15:21



**Amnistia ngec nëpër sirtarë/ Prokuroria vonon zbritjen e dënimit për 2868 persona në Shërbimin e Provës**

19/09 15:05

## Na ndiqni:



## I Video »



**Top News – Vendimet e Gjykatës Speciale/ Berisha: Ky problem ka apelimin si rrugë të vetme**



**Top News – “Po punojmë për zgjedhjet lokale” / Berisha: Plani për të larguar Ramën, ripërtëritje**



**Top News – Berisha prezanton planin: Do luftoj shpopullimin me çdo çmim, programi**



**Top News – Berisha pro hapjes së muzet hebraik në Vlorë: PD mbështet tolerancën fetare**



**Top News – “Rama lloboi për mua”/ Berisha: Unë nuk bëj njësoj, nuk do ndërhyjë për...**



**Top Channel/ SHBA-Kinë “në prag lufte”? “Drejt konfliktit ushtarak nga një raport i rremë i AI”!**

## Lajme

Lajmet e fundit  
Politikë  
Kronikë  
Aktualitet  
Ekonomi  
Sociale  
Video  
Top News LIVE

## Bota

Opinion  
Koment  
Kosova dhe Rajoni  
Shkencë dhe Teknologji  
Auto

## Sport

Kombëtarja  
Kategoria Superiore  
Kategoria e Parë  
Premier League  
La Liga  
Serie A  
Shumësportësh  
Sport Gossip

## Pop News

Showbiz  
Lifestyle  
Fashion  
Shëndeti  
Dieta  
Receta gatimi

## Programe

Big Brother VIP  
Për'puthen  
Shqipëria LIVE  
Fiks Fare  
Video  
Të gjitha programet  
Guida TV

## Top Channel

Rreth Top Channel  
Topin e kam unë – Apliko tanil  
Kontakt  
Puno në Top Channel  
Privacy Policy & Terms of Use  
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.